

**BEQIR META****NDIKIMI I VENDIMIT TË GJYKATËS SË HAGËS  
PËR SHKOLLAT PRIVATE NË PROCESIN  
E KOMBËTARIZIMIT TË INSTITUCIONEVE SHQIPTARE  
(1935-1938)**

Vendimi i Lidhjes së Kombeve që ndaloi shtetëzimin e shkollave private në zonën e minoritetit grek nxiti ndjenjat dhe aspiratat grekomane edhe në rajone të tjera, në të cilat, deri në këtë kohë, dukej se këto prirje ishin dobësuar. Pas vendimit të Gjyqit të Hagës dhe pas ndryshimit të qëndrimit të qeverisë shqiptare e cila, konform këtij vendimi, lejoi në shtator të vitit 1935 çeljen e shkollave private grekofone në fshatrat e minoritetit, atje ku ato kishin qenë para shtetëzimit, konsullatat dhe agjentët grekë arritën të rigjallëronin lëvizjen grekomane në disa zona të jugut të Shqipërisë.

**Ndikimet në Korçë dhe në Gjirokastrë**

Vendimi i Hagës nxiti një impuls të ri të grekomanizmit në prefekturën e Korçës, në çështjen e kishës ortodokse, të arsimit dhe më gjerë të ndjenjave grekomane. Prefektura e Korçës konstatonte se “pjesa grekomane e qarkut të Korçës e ka përkrahur në heshtje kërkesën e grekofonëve të Gjirokastrës, megjithëse ata e çmojnë se ky vendim nuk mund t’u sigurojë atyre një përfitim të njëjtë. Por është zgjuar shumë interesi për të krijuar, nën këtë maskë, privilegjet që ka patur elementi ortodoks qysh në kohët e kaluara, si në pikëpamje të formimit të ndjenjave të tyre grekofile, me anën e mësuesve të tyre të lirë fetar, ashtu dhe për me i siguru vetes një autoritet më të rrënjosur dhe më të gjerë, me qëllim që, me këto avantazhe, të shkatërrojnë sistemin e sotëm të Kishës Autoqefale Kombëtare, e cila u pengon sigurimin e privilegjeve dhe gjërave të tjera që ka patur më parë elementi ortodoks dhe dogma e tyre”<sup>1</sup>. Prefektura informonte se këto elementë grekomanë tashmë kishin

<sup>1</sup> Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSh), Fondi (më tej: F.) MPB, Viti (më tej: V.) 1935, Dosja (më tej: D.) 399, fl. 199-202, Prefektura e Korçës – MPB, 12 qershor 1935.

filluar të ndihmoheshin edhe prej një pjese të klerit, në krye të të cilit qëndronte edhe episkopi i Korçës, Kissi.

Në qoftë se u besohet raporteve që jepte prefektura e Korçës, del se qarqet grekomane ishin inkurajuar aq shumë nga situata e re e krijuar pas vendimit të Gjykatës së Hagës, sa që po ushtronin presion edhe ndaj nacionalistëve ortodoksë korçarë, që këta të hiqnin dorë nga mbështetja e kishës autoqefale dhe e institucioneve të tjera kombëtare. Në qershor 1935 prefektura informonte se qarqet grekomane “filluan të ndikonin edhe në qarqe patriotike, të cilat, megjithatë, nuk kanë arritur të shprehen në favor të tyre dhe as që besohet një gjë e tillë”<sup>2</sup>. Por, ndonëse nuk kishte mundur t’i tërhiqte këto elementë atdhetarë në hullinë e politikës greke, presioni i elementëve grekomanë nuk kishte kaluar tërësisht pa lënë gjurmë. Prefektura informonte se, “të influencuar nga avantazhet që u predikonte imzot Kissi, këto qarqe mendonin se do t’u sigurohej ndonjë privilegj më i gjerë fetar dhe ishin larguar, në mënyrë të dukshme, nga qëndrimi i tyre i mëparshëm (patriotik). Për rrjedhojë, kishin shfaqur një ftohtësi e cila, pak kohë më parë, nuk kishte qenë as e ndjerë dhe as e deklaruar.” Këtë bindje prefektura e Korçës e kishte formuar nga disa ngjarje që kishin një domethënie negative. Njëra prej tyre ishte zgjedhja e parisë së shoqërisë “Rinia Korçare”, gjatë së cilës elementi ortodoks ishte shprehur në mënyrë të dukshme në favor vetëm të kandidatëve ortodoksë, pa marrë parasysh inferioritetin ose superioritetin moral e kulturor dhe as përshtypjen që do të bënte zgjedhja e një partie të përbërë vetëm prej elementit ortodoks. Ky qëndrim, deri pak kohë më parë, ishte luftuar gjithmonë nga patriotët ortodoksë<sup>3</sup>.

Një pjesë e patriotëve ortodoksë kishin zhvilluar një përshtypje në favor të Kishës Unite. Ky qëndrim nuk kishte qenë rezultat i besimit të tyre, por ishte nxitur prej mërisë personale që ushqenin për kryetarin e Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare (KOASH), Visarionin, ekzistencën e të cilit në atë pozitë të lartë fetare e konsideronin si diskreditim për besimin ortodoks. Prefektura informonte se aktiviteti i fshehtë i imzot Kissit dhe predikimet e tij nën maskën fetare po i sillnin një dëm të madh “kolektivitetit shoqëror e vëllazëror të elementëve të Korçës”. Ajo dyshonte se, me këto qëndrime dhe me njerëzit që ai kishte

<sup>2</sup> *Po aty*, F. MPB, V. 1935, D. 399, fl. 199-202, Prefektura e Korçës – MPB, 12 qershor 1935.

<sup>3</sup> *Po aty*.

afruar pranë vetes, synonte të frymëzonte popullsinë ortodokse për “t’ia arritur ndonjë qëllimi të lig kundër sistemit ekzistues të KOASH”. Për këtë arsye, ajo propozonte transferimin e tij nga qarku i Korçës dhe zëvendësimin me At Vasil Markon, derisa të kthehej gjendja e mëparshme, domethënë “besimi e kënaqësia ndaj kishës dhe dashuria midis elementëve të ndryshëm”<sup>4</sup>.

Me nota edhe më të errëta e vlerësonte situatën por edhe rezultatet e politikës kombëtarizuese të qeverisë shqiptare konsulli italian i Vlorës.<sup>5</sup> Sadoqë vlerësimet e tij duhen marrë me rezervë, disa argumente që jepte ai pasqyronin vështirësitë e mëdha që ndeshte politika kombëtare e qeverisë shqiptare në këtë kohë. Ai shkruante se qeveria shqiptare, “duke e kuptuar shumë mirë pengesën që i sillte popullsia e krahinës së Gjirokastrës formimit të unitetit kombëtar, kishte marrë përsipër ta luftonte helenizmin me të gjitha mjetet, por nuk kishte arritur asgjë, madje kishte larguar nga vetja ortodoksët e pakët albanofonë, të cilët kishin përqafuar në fillim çështjen kombëtare shqiptare.”

Sipas konsullit Ettore Guglielmo Grande, shkaqet e mungesës së suksesit kishin dy burime: Në radhë të parë elementi greko-ortodoks, sipas tij, ishte më i zhvilluar, zotëronte një gradë qytetërimi më të lartë se sa pjesa tjetër e popullsisë dhe prandaj nuk mund të asimilohej nga elementi mysliman më inferior. Ai e cilësonte veprimin e qeverisë të papërshtatshëm pasi ajo, “për të luftuar helenizmin, nisi të luftonte ortodoksët në përgjithësi, duke i penguar në shfaqjet e tyre kulturore e fetare dhe duke ua nënshtruar gjithfarë lloj shtypjesh. Kështu që këta, nën trysninë në rritje të qeverisë dhe nën presionin, jo më pak të bezdisshëm, të bashkatdhetarëve myslimanë, u shtrënguan gjithnjë e më tepër pas Greqisë fqinje.”

Në epiqendër të kësaj pakënaqësie ai vendoste procesin e konsolidimit të autoqefalisë së kishës ortodokse shqiptare dhe shtetëzimin e shkollave greke. Ai shkruante se “formimi i kishës autoqefale së fundi, që u bë në kundërshtim me vullnetin e popullsisë dhe heqja graduale deri në eliminimin e shkollave greke arriti rezultatin që sot popullsia ortodokse e Shqipërisë Jugore kthen gjithnjë e më tepër

<sup>4</sup> *Po aty*.

<sup>5</sup> *Archivio del Ministero degli Affari Esteri*, Roma (më tej: *AMAE*), Affari Politici, 1931-1945, Albania, Busta 49, Minoranze greche (posiz. 1-2), Konsullata italiane në Vlorë për legatën italiane në Tiranë dhe MPJ në Romë, 21 maj 1935.

mendimin e vet drejt Greqisë, e cila e tërheq, gjithnjë e më tepër, me afinitetin e gjuhës dhe të fesë dhe me neverinë që ndjen ndaj elementit mysliman mbizotërues.”

Interesant është se Grande e krahasonte politikën nacionale të shtetit shqiptar me atë të Perandorisë Osmane. Sipas tij. “Turqia gjatë shekujve të pushtimit kishte ndjekur metoda krejt të ndryshme: mbështeti me miklime proselitizmin mysliman dhe pranoi sa më shumë kthime në këtë fe, po nuk ushtroi asnjë trysni mbi ata që s’deshën të hiqnin dorë nga feja e tyre dhe u la të gjithëve lirinë më të madhe të kultit dhe të kulturës, aq sa në të gjithë krahinën e Gjirokastrës ekzistonin veçse shkolla greke të mbajtura nga bashkësia që, jo vetëm toleroheshin nga qeveria turke, po madje inkurajoheshin”. Të njëjtën gjë ai theksonte edhe për kishën, e cila në periudhën osmane kishte qenë krejt e pavarur nga çdo ndërhyrje e shtetit. Konsulli Grande, duke injoruar tërësisht përpjekjet e nacionalistëve shqiptarë për arsimin dhe gjuhën shqipe në periudhën osmane, pohonte se vetëm më 1917 kishin lindur të parat shkolla shqiptare në atë krahinë, të cilat i kishte themeluar Komanda e Trupave të pushtimit italian.

Pikërisht këtë situatë, ai e cilësonte si shkak që çështja e shkollave minoritare helene mori përpjesëtime aq të mëdha në atë krahinë, aq sa fitoi një ngjyrim politik irredentist.<sup>6</sup>

Përfundimet dhe gjykimet e konsullit italian duhen parë në mënyrë kritike. Ai nuk e kuptonte dhe gjykonte drejt politikën e qeverisë shqiptare për ndërtimin dhe konsolidimin e institucioneve kombëtare dhe ekzagjeronte, si masat shtrënguese që kishte marrë qeveria kundër elementëve grekomanë dhe grekofonë që iu kundërvunë këtyre reformave, ashtu dhe gjerësinë apo sasinë e këtyre elementëve në prefekturën e Gjirokastrës. Ai nuk e kuptonte ose e injoronte domosdoshmërinë e procesit të kombëtarizimit të institucioneve arsimore e fetare si kusht themelor për ndërtimin e shtetit kombëtar. Gjithsesi, ky raport i konsullit italian vërteton se sa të vështirë e kishte pasur qeveria shqiptare të çonte përpara me sukses dhe me shpejtësi procesin e kombëtarizimit, i cili ishte kusht *sine qua non* për ekzistencën, mbijetesën dhe konsolidimin e shtetit shqiptar.

Por, konsulli italian i lartpërmendur konstatonte gjithashtu rolin e madh dhe të fuqishëm të konsullatave greke në zonën e prefekturës së

---

<sup>6</sup> *Po aty.*

Gjirokastrës. Ai nënvizonte faktin se në këtë zonë gjendeshin dy nënkonsullata greke të kategorisë së parë dhe pikërisht, një në Sarandë dhe një tjetër në Gjirokastrë, që të dyja të drejtuara nga funksionarë të karrierës. Ata luftonin për të forcuar sa më shumë depërtimin helen dhe për të mbështetur aktivitetin e klerit ortodoks, i cili, “ndonëse shqiptar, është i ndjeshëm më tepër ndaj autoritetit grek dhe forcës së traditës së trashëguar nga Patrikana se sa ndaj autoritetit politik lokal.” Këtë gjë e kishte dëshmuar më së miri çështja aktuale e shkollave greke. Grande nënvizonte edhe dobësinë e influencës italiane përballë asaj greke në këtë prefekturë. Ai i shkruante Romës se “përballë atij organizimi, Italia nuk zotëron në atë zonë veçse një Agjenci Mbretërore Konsullore në Sarandë”.<sup>7</sup>

Politika e qeverisë shqiptare për ruajtjen e institucioneve kombëtare pësoi një goditje të fortë edhe nga Italia, e cila këmbënguli dhe ushtroi presione të fuqishme që të rihapeshin shkollat italiane dhe veçanërisht ato katolike. Ministria e Jashtme italiane e cilësonte çështjen e shkollave konfesionale katolike si njërin prej aksioneve më të mëdha të Mbretit Zog për të luftuar influencën italiane në Shqipëri, pas refuzimit për ripërtëritjen e Paktit të vitit 1926, kur marrëdhëniet shqiptaro-italiane u futën në krizë. Ajo vërente se në fushën kulturore, ky aksion kishte filluar me ndalimin e frekuentimit të shkollave italiane nga nxënësit shqiptarë në vitin 1932, me pretekstin e vendosjes së drejtorëve administrativë shqiptarë në shkollat profesionale që mbaheshin me fondet italiane. Më tej, kjo fushatë kishte kulmuar me parashikimet ligjore të prillit 1933, kur qeveria shqiptare modifikoi dy artikuj të Statutit, duke vendosur mbylljen e të gjitha shkollave private. Roma nuk kishte asnjë dyshim për qëllimet e këtyre masave. Ajo pohonte se, siç rezultonte qartë nga manifestimet e shqiptarëve, ato ishin të drejtuara kundër instituteve të shumta katolike në lulëzim, pasi i cilësonte këto institute si instrumente të propagandës italiane, si për shkak të financimit nga Italia, ashtu edhe sepse shumica e mësuesve të tyre ishin italianë. Gjithashtu, ajo e cilësonte këtë masë si një reprezalje hakmarrëse kundër katolikëve shqiptarë të cilët, të drejtuar nga peshkopët e tyre, kishin shkuar në Romë në pranverën e vitit 1932 për t'i

---

<sup>7</sup> *Po aty.*

bërë homazhe Shenjtërisë së Tij dhe kryetarit të qeverisë italiane.<sup>8</sup> Ministria e Jashtme italiane pohonte se, qysh në fillim, nuk kishte kërkuar në mënyrë rigoroze rikthimin e *status quo*-së, por i kishte lënë hapësirë Mbretit Zog për të gjetur një zgjidhje të pranueshme për të dyja palët. Përpjekja e fundit ishte bërë për ta përfshirë këtë çështje në një Konkordat midis Shqipërisë dhe Selisë së Shenjtë, por edhe kjo tentativë nuk ishte realizuar. Tashmë, qeveria shqiptare kërkonte që çështja të diskutohej direkt me qeverinë italiane. Sipas Romës, tratativat midis Vatikanit dhe qeverisë shqiptare kishin dështuar, pasi Vatikani kishte kërkuar që laikët të lejoheshin të frekuentonin kurset e Seminareve dhe të instituteve të tjera fetare. Delegacioni shqiptar e kishte refuzuar këtë kërkesë. Në fakt, qeveria shqiptare kishte pranuar lejimin e frekuentimit të shkollave fetare katolike nga laikët, me kusht që kjo të sanksionohej nëpërmjet akteve administrative dhe jo legjislative, por Vatikani nuk e kishte pranuar këtë propozim dhe ngulte këmbë që kjo të sanksionohej me ligj.<sup>9</sup> Legata italiane në Tiranë mendonte se mosmarrëveshjet midis Romës dhe Tiranës për këtë çështje nuk ishin të pakapërcyeshme, por qeverisë shqiptare do t'i duhej të bënte lëshime dhe, nga ana tjetër, edhe italianët duhej të pranonin kufizimin e numrit të shkollave fetare katolike.<sup>10</sup>

Pala italiane projektonte të bënte këto propozime për zgjidhjen e kësaj çështjeje: t'i kërkohej Vatikanit të pranonte që e drejta e frekuentimit të shkollave katolike nga laikët të konfirmohej në mënyrë administrative dhe jo ligjore. Por, në këtë rast, qeveria shqiptare të angazhohej, përmes një note zyrtare sekrete dhe prefektët e Shkodrës dhe të Tiranës, pas kërkesave të marra nga të interesuarit (peshkopët katolikë) t'u komunikonin atyre lejimin e frekuentimit të shkollave sipas kërkesave të tyre. Frekuentimi i këtyre shkollave nga laikët do të ishte i kufizuar sipas urdhrave fetarë, ashtu siç ata ekzistonin në Shqipëri. Gjithashtu, duhej kërkuar, por jo me këmbëngulje, rihapja e konvikteve për fëmijë dhe jetimë, duke u dhënë atyre edhe mësim.<sup>11</sup>

<sup>8</sup> AMAE, Affari Politici, 1931-1945, Albania, Busta 49, Trattative italo-albanesi (posiz.1-4), Raport i Zyrës për Shqipërinë (Ufficio Albania) për nënsekretarin e Shtetit (sottosegretario di Stato), 18 mars 1935.

<sup>9</sup> *Po aty.*

<sup>10</sup> *Po aty.*

<sup>11</sup> *Po aty.*

Zogu, duke e ndjerë presionin italian dhe atë grek njëherazi, disa javë më parë, ishte përpjekur të qetësonte ujërat me Romën. Ai i kishte propozuar ministrit italian Indelli një sërë marrëveshjesh me Italinë, të cilat ulnin tensionin me qeverinë e Musolinit. Midis këtyre propozimeve, ai sugjeroi edhe një marrëveshje për dërgimin e disa mësuesve italianë në shkollat sekondare shqiptare, si për dhënien e gjuhës italiane ashtu edhe për lëndë të tjera. Gjithashtu, ai sugjeroi që mësues të tillë të pranoheshin edhe në gjimnazin shqiptar të Shkodrës. Ky propozim bëhej në një kohë kur negociatat me Selinë e Shenjtë kishin ngecur.<sup>12</sup> Vera e vitit 1935 shënon një kufi kohor të rëndësishëm e cila përmbyll një periudhë historike kur, me gjithë vështirësitë, disa nga të cilat i trajtuam më lart, shteti shqiptar ishte në aksion të vazhdueshëm për të kapërcyer problematikën e vështirë dhe delikate që dilte para tij për formimin e konsolidimin e kombit-shtet, të ndërgjegjes dhe institucioneve kombëtare. Në këtë betejë tepër të vështirë u arritën një sërë suksesesh, shumë më tepër se në çdo periudhë tjetër historike. Por, nga ana tjetër, pati edhe mjaft dështime të cilat lidheshin me faktorë të karakterit objektiv, si presioni i fuqishëm që vinte nga fqinjët apo nga disa organizma ndërkombëtarë si dhe nga trashëgimia që vinte prej së kaluarës, e cila kishte lënë rrënjë të thella në ndërgjegjen e disa grupeve të popullsisë. Gjithashtu, pati edhe disa probleme relativisht të vogla që u krijuan nga gabimet në trajtimin e këtyre çështjeve tepër delikate dhe të ndjeshme. Sidoqoftë, dukej se shteti shqiptar po ecte në rrugë të mbarë drejt unifikimit kombëtar dhe konsolidimit të ndërgjegjes e institucioneve kombëtare. Por, procesi ishte ende i papërfunduar.

Pas vitit 1935 filluan të ndjehen edhe më shumë pasojat e vendimeve të Gjykatës së Hagës. Opinioni publik shqiptar reagoi në mbrojtje të institucioneve kombëtare. Në mbrojtje të shkollave publike u vu edhe shtypi shqiptar, i cili i vlerësoi ato si institucione të rëndësishme kombëtare. Në shtator 1936, "Gazeta e Korçës" shkruante se prindërit shqiptarë duhet të vinin dashurinë ndaj atdheut, përpara çdo ndjenje tjetër dhe t'ia besonin edukatën e fëmijëve të tyre shkollave të shtetit që po edukonin kombëtarisht brezin e ri. "Kështu do të arrihet plotësisht uniteti ynë kombëtar mbi fetë dhe mbi krahinat", shkruante ajo<sup>13</sup>. Sipas saj,

<sup>12</sup> AMAE, Affari Politico, 1931-1945, Albania, Busta 49, Trattative italo-albanesi (posiz. 1-4), Legata italiane në Tiranë për MPJ në Romë, 23 janar 1935.

<sup>13</sup> "Shkollat shtetërore e private", në *Gazeta e Korçës*, 23 shtator 1936.

shkolla unike shtetërore ishte një kusht edhe për kombet e tjera me qytetërim të vjetër dhe me unitet kombëtar të realizuar prej shekujsh, ndërsa “për ne është një nevojë e domosdoshme dhe imperative”.

Në gazetën e lartpërmendur vlerësoheshin pozitivisht disa shkolla private që i kishin sjellë dobi kombit shqiptar në kohën e sundimit të huaj, por tashmë, situata kishte ndryshuar tërësisht dhe Shqipëria ishte një shtet kombëtar dhe i përditshëm. Ajo u kujtonte prindërve shqiptarë se nuk duhej të harronin artikullin e ligjit të posaçëm që theksonte se, “për t’u marrë në nëpunësi shtetërore, diploma e shkollave të mesme private duhej rivlerësuar, duke dhënë një provim, kurse ato të shkollave shtetërore, në mënyrë të arsyeshme, përjashtoheshin nga ky provim”<sup>14</sup>.

Sigurisht që grekët nuk do të kënaqeshin me zbatimin korrekt të vendimit të Gjykatës së Hagës nga qeveria shqiptare. Ata do ta vlerësonin atë vetëm si një avantazh të rëndësishëm që ndihmonte politikën e tyre konsistente dhe të kalkuluar mirë për fuqizimin e helenizmit në Shqipërinë e Jugut.

Shenjat e një lëvizjeje të kamufluar të grekëve po dukeshin edhe në prefekturën e Korçës. Në nëntor 1937, në fshatin Orman Çiflik po çelej një shkollë private greke me mësues të paguar prej fshatit dhe po largoheshin nga shkolla shtetërore 10 nxënës. Edhe në qytetin e Korçës ekzistonin dy shkolla private greke me pagesë për vajza të rritura. Mësuese të tyre ishin dy murgesha<sup>15</sup>. Prefektura e Korçës urdhëroi që shkolla në Orman Çiflik të mos hapej pa autorizimin e Ministrisë së Arsimit<sup>16</sup>.

Në vitin 1938 vijoi të përhapej fenomeni i hapjes së shkollave minoritare në fshatra jominoritare. Këto veprime bëheshin me nxitjen e konsullatave greke. Kështu në fillim të vitit 1938, Këshilli i Ministrave urdhëroi mbylljen e shkollës minoritare të fshatit Vromero të Sarandës, për arsye se ajo shkollë ishte hapur pa leje, katundi s’kishte pasur kurrë më parë shkollë private dhe se banorët e tij ishin regjistruar si shqiptarë e jo si grekofonë<sup>17</sup>. Prefektura e Gjirokastrës informonte Ministrinë e Brendshme se burrat e këtij fshati flisnin në shtëpi gjuhën shqipe, një

<sup>14</sup> Po aty.

<sup>15</sup> *AQSh*, F. MPB, V. 1937, D. 144, fl.7, Inspektorja e Arsimit Korçë – MA, 6 nëntor 1937.

<sup>16</sup> Po aty.

<sup>17</sup> Po aty, F. MPB, V. 1938, D. 217, fl.1, Kryesia e Këshillit të Ministrave – Ministrisë së Arsimit, 4 shkurt 1938.

pjesë e grave dhe fëmijëve pëlqenin dhe përdornin në shtëpi gjuhën greke, kurse jashtë shtëpisë, për çdo gjë, flisnin shqip. Prefekti i Gjirokastrës theksonte se gjuha greke në këtë katund mund të kishte hyrë nga krushqitë që banorët e tij kishin bërë me katundet grekofone<sup>18</sup>. Më vonë, qeveria u tërhoq dhe Ministria e Arsimit udhëzoi prefekturën e Gjirokastrës që pleqësia e Vromeros të bënte formalitetet ligjore për çeljen e shkollës greke, në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave të 18 majit të vitit 1938<sup>19</sup>. Prefektura e Gjirokastrës e kundërshtoi këtë udhëzim, duke këmbëngulur se banorët e këtij fshati ishin me origjinë shqiptare dhe flisnin shqip. Mirëpo, Këshilli i Ministrave nuk e ndryshoi vendimin e tij dhe dha lejen për hapjen e shkollës private greke në Vromero<sup>20</sup>.

Një dëshmi tjetër se, lëshimet që kishte bërë qeveria shqiptare pas vendimit të Gjyqit të Hagës, e kishin inkurajuar nacionalizmin grek të ecte përpara në veprimtarinë e tij ishte edhe qëndrimi i personelit të shkollave minoritare greke, i cili po demonstronte veprime anti-shqiptare<sup>21</sup>.

### **Nxitja e aktivitetit të elementëve grekomanë në Himarë**

Pranimi prej qeverisë shqiptare i vendimit të Hagës i bëri edhe më aktivë elementët grekomanë në Himarë. Në gusht të vitit 1935, paria grekomane kërkoi mësimin e greqishtes me më tepër orë mësimore se sa mësimin në gjuhën shqipe dhe u përpoq të rigjallëronte përpjekjet për shkëputjen e kishës lokale nga KOASH. Madje, një pjesë e popullsisë së fshatit Dhërmi shkoi edhe më larg, duke kërkuar një status të barabartë me shkollat e minoritetit grekofon. Ata kërkuan që të kthehej gjendja që kishte ekzistuar para vitit 1921, duke pohuar se nuk kishin marrë pjesë në lëvizjen e minoritetit grekofon një vit më parë, jo se kishin hequr dorë

<sup>18</sup> *Po aty*, F. MPB, V. 1938, D. 217, fl.7, Prefektura e Gjirokastrës – MPB, 3 maj 1938.

<sup>19</sup> *Po aty*, F. MPB, V. 1938, D. 217, fl. 10, MA – Prefekturës Gjirokastër, 24 maj 1938.

<sup>20</sup> *Po aty*.

<sup>21</sup> *Po aty*, F. MPB, V. 1938, D. 217, fl. 20-25, Prefektura e Gjirokastrës-MPB, 1 korrik 1938.

nga “të drejtat” e tyre, “por se nuk kishin dëshirë të interpretoheshin keq ndjenjat e mira” të tyre kundrejt qeverisë<sup>22</sup>.

Inspektoria e Arsimit të Vlorës njoftonte se lëvizja e elementëve grekofilë ishte shkaktuar nga propaganda e huaj dhe pagesat që po u bëheshin propagandistëve vendas. Në emër të popullsisë së Himarës, ishin dërguar telegrame në të cilat shpaloseshin kërkesat greke. Banorëve të Himarës, Dhërmiut e Palasës, u ishin marrë firmat, duke i mashtruar, pa u treguar qëllimin e këtyre telegrameve ose ishin vënë edhe firma të falsifikuara<sup>23</sup>. Duke parë situatën e krijuar, Ministria e Brendshme udhëzoi prefekturën e Vlorës që të shtoheshin forcat e xhandarmërisë për të përballuar ndonjë situatë të papritur. Gjithashtu, ajo dha porosi që demonstratat e elementëve antigrekë të mos i kapërcenin kufijtë dhe të mos shkaktohej ndonjë incident<sup>24</sup>.

Nga ana tjetër, aktivistët himarjotë me ndjenja proshqiptare, kërkuan që të mbroheshin me forcë institucionet kombëtare. Ata, gjithashtu kërkuan të përmirësohej niveli i administratës lokale, me qëllim që të zhvillonin me sukses betejën kundër propagandës greke dhe elementëve grekomanë. Në një letër që i drejtuan kryeministrit më 3 shtator 1935, ata e njoftonin se “kishin hedhur një hap të madh për të kundërshtuar elementët himarjotë me ndjenja të ndryshkura grekomanë”. Por për të patur sukses, ata kërkonin largimin e nënprefektit Ymer Faslliu dhe të sekretarit të nënprefekturës Ramiz Harxhi, “pasi ata nuk dinin të bënin politikë dhe kishin krijuar antipati në popull”<sup>25</sup>.

Më 11 shtator, një grup i madh banorësh të Dhërmiut, i përbërë nga djem intelektualë dhe pleq, zhvilluan një demonstratë në qendër të Himarës. Ata kënduan atje Himnin Kombëtar Shqiptar dhe Himnin e Mbretit dhe i dërguan prefekturës së Vlorës këtë telegram: “Populli i katundit Dhërmi nuk e bashkon aspak fatin dhe ndjenjat e tij shekullore shqiptare me pakicat e tjera grekofone, por mbetet gjithmonë në favor të

<sup>22</sup> *Po aty*, F. MPB, V. 1935, D. 399/1, fl. 141, Lutje e disa banorëve të Dhërmiut dërguar Ministrisë së Arsimit, 31 gusht 1935.

<sup>23</sup> *Po aty*, F. MA, V. 1935, D. 51, fl. 279, Inspektoria e Arsimit Vlorë – MA, 11 shtator 1935.

<sup>24</sup> *Po aty*, F. MPB, V. 1935, D. 399/b, fl. 465, MPB – Prefekturës Vlorë, 28 shtator 1935.

<sup>25</sup> *Po aty*, F. MPB, V. 1935, D. 399/1b, fl. 517, Lutje e disa banorëve të Himarës – Kryeministrit, 3 shtator 1935.

qeverisë dhe refuzon kategorikisht influencat dhe propagandat e huaja, duke mbetur gjithmonë i bindur në ndjenjat e tij kombëtare<sup>26</sup>.

Disa djem himarjotë, nën drejtimin e Dhimitri Konomit, u nisën për në Palasë për të bërë një demonstratë kundër hapjes së shkollave greke atje<sup>27</sup>. Autoritetet lokale morën masa për të mbështetur krahun proshqiptar. Nënprefektura e Himarës i propozoi prefekturës së Vlorës që disa djemve himarjotë, me ndjenja kombëtare, t'u jepeshin bursa për në Normalen e Elbasanit<sup>28</sup>. Gjithashtu, disa djem që përkrahnin shkollën shqipe në Himarë u përjashtuan nga kryerja e shërbimit ushtarak<sup>29</sup>. Edhe rryma grekomane reagoi. Ikonomi Dhimitër Shisko dhe Atë Kozma Billa mallkuan në kishë të gjithë ata që kishin shfaqur ndjenjat kombëtare shqiptare dhe kishin protestuar kundër shkollave greke<sup>30</sup>. Konsulli grek i Sarandës i inkurajonte banorët e Dhërmiut, duke u thënë se Lidhja e Kombeve i kishte njohur si minoritet<sup>31</sup>. Edhe konsullata greke e Vlorës po zhvillonte një aktivitet të madh në Himarë rreth çështjes së shkollave. Ajo po shpërndante të holla në popullsinë e Himarës për ta nxitur të kërkonte çeljen e shkollave greke<sup>32</sup>. Konsulli grek i Sarandës u kishte dhënë mësuesve të Himarës tre muaj rrogë, duke i nxitur për të hapur shkollat private<sup>33</sup>.

Në anën tjetër, edhe propaganda e patriotëve shqiptarë kundër shkollave greke po vazhonte të rritej. Ministria e Brendshme vijonte të jepte udhëzime që propaganda kombëtare të ndiqte një vijë të butë dhe të

<sup>26</sup> *Po aty*, F. MPB, V. 1935, D. 399/a, fl. 384, Telegram i përfaqësuesve e kryepjeqeve të Dhërmiut – Prefekturës Vlorë, 11 shtator 1935.

<sup>27</sup> *Po aty*, F. MPB, V. 1935, D. 399/b, fl. 427, Prefektura Vlorë – MPB, 19 shtator 1935.

<sup>28</sup> *Po aty*, F. MPB, V. 1935, D. 399/b, fl. 444, N/prefektura e Bregut të Detit – Prefekturës-Vlorë.

<sup>29</sup> *Po aty*, F. MPB, V. 1935, D. 399/1a.

<sup>30</sup> *Po aty*, F. MPB, V. 1935, D. 399/1, fl. 8, Prefektura Vlorë – MPB, 23 shtator 1935.

<sup>31</sup> *Po aty*, F. MPB, V. 1935, D.399/1, fl. 33, Nënprefektura Himarë – MPB, 1 tetor 1935.

<sup>32</sup> *Po aty*, F. MPB, V. 1935, D.399/1, fl. 197, Prefektura e Beratit – MPB, 10 tetor 1935.

<sup>33</sup> *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej: AMPJ)*, V. 1935, D. 297, fl. 134, Inspektoria e Arsimit Vlorë – MA, 24 tetor 1935.

mos krijoheshin incidente<sup>34</sup>. Në fillim të tetorit 1935, në Palasë po shtohesh numri i banorëve që firmosën një peticion për shkollën kombëtare shqiptare, ndërsa në Dhërmi numri i mbështetësve të saj kishte arritur në 200<sup>35</sup>. Në peticionin e banorëve të Dhërmiut kërkohesh që të vazhdonte situata e mëparshme sepse, po të shtoheshin orët e greqishtes në shkollë, “nuk mund të kemi asnjë sadsifaksion moral e material, veçse përbuzjen indirekte të Shqipërisë mbarë, pasi neve jemi vetëm një element i pandarë i kombit shqiptar, në çdo pikëpamje, historikisht, nga ana gjuhësore dhe në traditat e përgjithshme”<sup>36</sup>.

Për të zgjidhur turbullirat që ishin shfaqur në çështjen kishtarë, shkoi në Himarë në ditët e para të tetorit Kristofor Kisi. Ai u prit nga paria e Himarës me nderime dhe me një ceremoni madhështore. Pasi hetoi personalisht, ai miratoi masat që kishin marrë autoritetet shtetërore kundër priftit të Palasës dhe përkrahësve të tij, e pranoi mbajtjen e tij nën vërejtje dhe urdhëroi mitropolitin e Beratit që ta transferonte larg këtij qarku<sup>37</sup>. Megjithatë, pas largimit të tij, komisioni grekofil filloi menjëherë fushatën e mëparshme përçarëse.

Duhet theksuar se në fillim të tetorit 1935, lëvizja grekomane kishte arritur ta dëmtonte frekuentimin e shkollës shqipe në disa fshatra. Kështu, në Himarë vitin e kaluar kishin frekuentuar shkollën 145 meshkuj e 60 femra, kurse në këtë kohë ishin regjistruar 5 meshkuj dhe asnjë vajzë. Në Dhërmi, vitin e mëparshëm kishte patur 147 nxënës, kurse tani ishin regjistruar 75, në Palasë, nga 46 nxënës, ishin regjistruar 18<sup>38</sup>.

Disa banorë po kërkonin tërthorazi favore, kryesisht bursa e nënpunësira të niveleve jo të larta, në këmbim të mbështetjes së veprimtarive dhe institucioneve shqiptare. Autoritetet e nënprefekturës u kishin dhënë premtime se këto kërkesa do të plotësoheshin në qoftë se ata do të dërgonin fëmijët në shkolla dhe do të nënshkruanin kundër

<sup>34</sup> *AQSh*, F. MPB, V. 1935, D. 399/1, fl. 38, MPB – Nënprefekturës Himarë, 2 tetor 1935.

<sup>35</sup> *Po aty*, F. MPB, V. 1935, D. 399/1, fl. 52, Nënprefektura Himarë – MPB, 4 tetor 1935.

<sup>36</sup> *Po aty*, F. MPB, V. 1935, D. 399/1, fl. 140, Lutje e banorëve të Dhërmiut dërguar nënprefekturës Himarë, 8 shtator 1935.

<sup>37</sup> *Po aty*, F. MPB, V. 1935, D. 399/1, fl. 60, Nënprefektura Himarë - MPB, 4 dhe 5 tetor 1935.

<sup>38</sup> *Po aty*, F. MPB, V. 1935, D. 399/1, fl. 159, Nënprefektura Himarë - MPB, 8 tetor 1935.

greqishtes<sup>39</sup>. Në Himarë ishin mbledhur 40 nënshkrime kundër shkollave greke. Nënprefektura e cilësonte të suksesshëm aktivitetin e Komisionit Himarjot për shkollën shqipe dhe shfaqte shpresën se, së shpejti, do të arrihej regjistrimi në masë i nxënësve në shkolla<sup>40</sup>. Komisioni Kombëtar drejtohej nga Dhimitër Konomi, avokati Thoma Jani dhe nëntogeri Vangjel Jani. Dy-tre ditë më vonë numri i nënshkrimeve kundër shkollës greke u rrit. Në Himarë ky numër arriti në 60 nënshkrime. Ishte rritur edhe numri i nxënësve të regjistruar. Në Dhërmi ishin regjistruar 66 nxënës, në Palasë 23 nxënës, në Himarë 10 nxënës.

Gjithsesi situata në tetor 1935 ishte e paqartë dhe nuk mund të përcaktohej se cila palë po fitonte epërsi. Fitoret apo humbjet e palëve kundërshtarë ishin të përkohshme dhe të paqëndrueshme. Kështu, kundërshtarët e shkollës shqipe në Palasë ishin dobësuar shumë dhe tani kishin mbetur vetëm 5-6 veta. Komisioni Kombëtar po zhvillonte bisedime me kundërshtarët dhe pritej që ato të përfundonin në favor të interesave të shtetit shqiptar<sup>41</sup>. Mirëpo dy ditë më vonë komisioni progrek refuzoi të zhvillonte bisedime të tjera për këtë çështje<sup>42</sup>.

Interesant është fakti se, nga ballafaqimi i politikës greke dhe asaj shqiptare për Himarën, një pjesë e popullsisë lokale u përpoq të nxirrte përfitime materiale. Disa persona e kthyen në një biznes fitimprurës kundërshtimin e shkollave dhe institucioneve shqiptare dhe përkrahjen e shkollës dhe kishës greke, duke u shndërruar kështu në tregtarë shpirtrash dhe ndjenjash të cilët manipulonin popullsinë e paarsimuar dhe me një ndërgjegje politike të paformuar. Kjo ishte ndoshta ana më e shëmtuar dhe qesharake e kësaj përplasjeje politike. Kuptohet që pala greke ishte më superiore në këtë drejtim, pasi dispononte mjete më të fuqishme financiare. Nënprefektura e Himarës informonte: “mentaliteti i kundërshtarëve të shkollës shqipe është tërësisht materializëm dhe asgjë tjetër. Me një mentalitet të tillë janë gjithë banorët e këtij rrethi si dhe nëpunësit që janë anëtarë të komisionit, të cilët merren me propozime se

<sup>39</sup> *Po aty*, F. MPB, V. 1935, D. 399/1, fl. 165, Nënprefektura Himarë - MPB, 9 tetor 1935.

<sup>40</sup> *Po aty*, F. MBP, V. 1935, D. 399/1a, fl. 235, Nënprefektura Himarë - MPB, 11 tetor 1935.

<sup>41</sup> *Po aty*, F. MBP, V. 1935, D. 399/1a, fl. 276, Nënprefektura Himarë - MPB, 14 tetor 1935.

<sup>42</sup> *Po aty*, F. MBP, V. 1935, D. 399/1a, fl. 332, Nënprefektura Himarë - MPB, 17 tetor 1935.

ku do të përfitojnë dhe ne u bëjmë premtime se jemi ngushtë. Me një fjalë, formuam mendimin se ky rreth nuk ka asnjë ide, veç materializmit dhe është i zhveshur tërësisht nga ndjenja morale, njerëzore e sidomos patriotike”<sup>43</sup>.

Përkundrazi, për drejtuesit e komisionit që luftonte për shkollën shqipe, nënprefektura informonte se po punonin me idealizëm, madje po bënin sakrificë materiale për mbështetjen e shkollës kombëtare, megjithëse ishin të vobektë dhe pa të ardhura<sup>44</sup>. Por kishte disa anëtarë të tjerë të këtij komisioni, të përbërë nga nëpunës të shtetit që ishin dërguar në Himarë, të cilët vlerësoheshin nga autoritetet lokale si të paefektshëm e të padobishëm. Ata cilësoheshin si persona që populli i Himarës nuk i donte dhe se gjithnjë po kërkonin t’i jepnin fisit të tyre nëpunësira dhe privilegje të tjera. Komanda e xhandarmërisë kërkonte largimin e tyre, duke e justifikuar se: “këto nuk janë idealista, veç materialista dhe njerëz pa farë karakteri”. Ajo pohonte se popullsia e katundit Himarë ishte kompakte dhe mendimi i saj filogrek nuk do të ndryshonte nga askush. Kështu ajo propozonte marrjen e masave shtrënguese sistematike sepse, me qëndrimin e jashtëzakonshëm tolerant që po mbahej, po binte autoriteti dhe prestigji i institucioneve shtetërore lokale dhe i gjithë shtetit. Ndërsa, situatën në Palasë e Dhërmi e vlerësonte më pozitive, falë përpjekjeve të patriotit Dhimitër Konomi<sup>45</sup>.

Sipas nënprefekturës, presioni grek ndaj popullsisë së Himarës po ushtrohej në formë të ndryshme ekonomike dhe administrative. Popullsia e Himarës ishte e lidhur ngushtë me interesa jetike me kapitalistin Jorgji Bollano, të cilit i detyrohej shumë. Ky e përdorte këtë pozitë, të cilën e kishte fituar me mbështetjen e autoriteteve greke, për të ushtruar presion mbi himarjotët, që ata t’u shkonin pas elementëve grekomanë. Gjithashtu, himarjotët e dinin se përkrahja e tyre për shkollën shqipe do të shkaktonte refuzimin e vizave të pasaportave nga konsullata greke. Në këtë mënyrë,

<sup>43</sup> *Po aty*, F. MBP, V. 1935, D. 399/1a, fl. 306, Nënnprefektura Himarë – MPB, 16 tetor 1935.

<sup>44</sup> *Po aty*, F. MBP, V. 1935, D. 399/1a, fl. 313, Nënnprefektura Himarë – MPB, 16 tetor 1935.

<sup>45</sup> *Po aty*, F. MBP, V. 1935, D. 399/a, fl. 390, Komanda e Xhandarmërisë Himarë – Komandës së Përgjithshme të Xhandarmërisë, Tiranë, 18 tetor 1935.

ata do të pësonin dëme të mëdha në tregtinë e tyre me Greqinë, e cila ishte jetike për ta<sup>46</sup>.

Konsullatat greke në Shqipëri u kishin refuzuar dhënien e vizave himarjotëve që kishin kërkuar shkolla shqipe. Nënprefektura e Himarës ishte e shqetësuar se ky presion i konsullatës greke do të inkurajonte kundërshtarët e shkollës shqipe dhe do të vinte në rrezik gjithë sukseset që ishin arritur deri në atë kohë në Dhërmi e Palasë<sup>47</sup>. Gjithashtu, në Greqi po u krijoheshin pengesa atyre shtetasve shqiptarë, të afërmit e të cilëve në Himarë kishin kërkuar shkolla shtetërore shqipe dhe jo shkolla private greke.<sup>48</sup>

Më 18 tetor 1935, komisioni për shkollat greke i kërkoi nënprefekturës hapjen e shkollave private tërësisht greke, në të cilat gjuha shqipe do të mësohej vetëm 6 orë në javë. Qëndrimi i këtij komisioni ishte kokëfortë e intransigent, prandaj, për të mos demoralizuar e larguar pjesën e popullsisë që mbështeste shkollat shqipe të Dhërmiut, Palasës e Himarës, nënprefektura propozoi internimin e tre personave nga Himara. Ajo pohonte se qëndrimi i urtë e tolerant i deriatëhershëm kishte shtuar kurajën e tyre për të kundërshtuar shtetin dhe po rrëzohej prestigji e dinjteti qeveritar e kombëtar<sup>49</sup>. Por, Ministria e Brendshme e kundërshtoi marrjen e këtyre masave në këtë moment<sup>50</sup>.

Për të kuptuar më mirë se cila ishte mbështetja për shkollën shqipe në tetor të vitit 1935, shërbejnë të dhënat që Inspektori i Arsimit të Vlorës i dërgonte Ministrisë së Arsimit. Ai informonte se, në këtë kohë në Palasë ishin regjistruar dhe vazhdonin shkollën vetëm 25 nxënës, në shkollën e Dhërmiut ishin regjistruar 84 dhe vijonin shkollën 72 nxënës, në shkollën e qendrës Himarë ishin regjistruar 6 nxënës dhe vazhdonin 5 nxënës.

<sup>46</sup> *Po aty*, F. MBP, V. 1935, D. 399/1b, fl. 403, Nënprefektura Himarë – MPB, 22 tetor 1935.

<sup>47</sup> *AQSh*, F. MBP, V. 1935, D. 399/1b, fl. 416, Nënprefektura Himarë – MPB, 24 tetor 1935.

<sup>48</sup> *Po aty*, F. MBP, V. 1935, D. 399/1b, fl. 459, MPB – MPJ, 29 tetor 1935.

<sup>49</sup> *Po aty*, F. MBP, V. 1935, D. 399/a, fl. 353, Nënprefektura Himarë – MPB, 18 tetor 1935.

<sup>50</sup> *Po aty*, F. MBP, V. 1935, D. 399/1a, fl. 357, MPB - Nënprefekturës Himarë, 21 tetor 1935.

Edhe këta pak nxënës që ishin në shkollën e qendrës në Himarë po mbaheshin me shumë vështirësi dhe me “përkëdhelira”<sup>51</sup>.

Inspektorja e cilësonte reaksionin në Himarë si të padurueshëm dhe masat e marra të paefektshme. Veçanërisht ajo kritikonte komisionin e nëpunësve të cilët, në ndonjë rast, kishin bërë edhe një lojë të dyfishtë. Ajo sugjeronte marrjen e masave energjike shtrënguese kundër propagandistëve të huaj dhe vendas, transferimin e disa zyrtarëve lokalë dhe zëvendësimin e tyre me njerëz energjikë që njihnin mirë mentalitetin e popullit, të pushoheshin nëpunësit himarjotë në administratën shtetërore, të ndalohej aktiviteti i atyre që kryenin shërbime publike, si mjekë, avokatë për një kohë të pacaktuar, në mënyrë që ata t’u bindeshin ligjeve që ishin në fuqi dhe kësaj krahine t’i hiqeshin të gjitha privilegjet, sidomos ato që gëzonte në pagesën e taksave qeveritare<sup>52</sup>. Pra duket qartë se midis organeve lokale dhe atyre qendrore kishte një mospërputhje të dukshme lidhur me mënyrën e veprimit në Himarë. Organet lokale, që përballëshin direkt me lëvizjen grekomane kërkonin marrjen e masave administrative rigorozë, ndërsa qeveria, e cila i peshonte efektet e këtyre masave në një prizëm më të gjerë kombëtar e ndërkombëtar, refuzonte zbatimin e tyre dhe kërkonte ndjekjen e një politike sa më të moderuar e luajale.

Ndryshe nga Himara, në Dhërmi e Palasë politika qeveritare po fitonte epërsi. Më 29 tetor, nënprefektura e Himarës njoftonte se në Dhërmi edhe 10 familje të tjera kishin mbështetur shkollën shqipe dhe pjesa kundërshtarë grekofile kishte ngelur krejt në pakicë. “Kështu propaganda greke në Dhërmi e Palasë falimentoi dhe shkollat atje janë duke vazhduar rregullisht”<sup>53</sup>.

Megjithatë këto pohime mund të pasqyronin vetëm situatën momentale pasi konsullata greke e Sarandës po vazhdonte propagandën hapur dhe pa kurrfarë ndrojtje. Nënprefektura e Himarës informonte se konsullata greke e Sarandës, së bashku me tregtarin grek të atij qyteti, Mazaraqi, ishin përpjekur të largonin nga grupi i mbështetësve të shkollës shqipe Doktor Milon, i cili përfaqësonte një familje të madhe me ndjenja patriotike shqiptare, që mbështeste shkollën shqipe dhe kishte influencën

<sup>51</sup> *Po aty*, F. MBP, V. 1935, D. 399/a, fl. 383-384, Inspektorja e Arsimit Vlorë - MA, 21 tetor 1935.

<sup>52</sup> *Po aty*.

<sup>53</sup> *Po aty*, F. MBP, V. 1935, D. 399/1b, fl. 470, Nënprefektura Himarë – MPB, 29 tetor 1935.

kryesore në qëndrimet e fshatit Dhërmi pro shkollës shqipe. Ata i kishin propozuar djalit të tij, Vasil Milos postin e inspektorit të shkollave grekofone, me një rrogë të majme prej 300 fr. ari në muaj, me kusht që familja e tij të bashkohej me grupin grekoman dhe të largonte fëmijët e vet nga shkollat shtetërore shqipe. Mirëpo ai nuk e pranoi kërkesën e tyre<sup>54</sup>.

Në nëntor të vitit 1935 shumica e popullsisë së Himarës bëri një deklaratë tjetër në favor të mësimit shqip në shkollat shtetërore dhe kundër mësimit të greqishtes në shkollat private me mësues privatë<sup>55</sup>.

Megjithëse kishte ardhur duke i ngushtuar venomet e vjetra të periudhës osmane, qeveria shqiptare kishte ndjekur, përgjithësisht, një politikë të butë që bazohej në kompromisin me rrymën grekomane dhe në tërheqjen e ngadalshme e të butë, pa eksese, të popullsisë së Himarës në gjirin e kombit të cilit i përkiste. Qysh prej vitit 1930 deri në vitin 1935 Ministria e Arsimit u kishte dhënë leje këtyre tre katundeve që fëmijët e tyre të zhvillonin greqishten një orë në ditë. Gjithashtu ishte toleruar edhe mësimi i fesë që të zhvillohej në greqisht, jashtë shkollës prej mësuesve të greqishtes<sup>56</sup>.

Edhe gjatë vitit 1936, megjithëse në zonën e Himarës propaganda greke kishte përqendruar gjithë arsenalin e saj, elementët atdhetarë shqiptarë reagues vendosmërisht kundër koncesioneve që i ishin bërë politikës greke nga qeveria shqiptare. Kryepleqtë e fshatrave Dhërmi, Himarë e Palasë i dërguan më 10 shtator një telegram Mbretit Zog, me të cilin protestonin energjikisht kundër “të vetëquajturve pari që po cenonin shqiptarësinë, traditat e zakonet tona”. Ata pohonin se këto veprime “ishin shtyrë nga interesa personale dhe ishin të frymëzuara e të financuara nga propaganda të huaja, që ishin në dëm të interesave kombëtare dhe të politikës së Mbretërisë Shqiptare”<sup>57</sup>.

Himara përbënte një shqetësim për qeverinë, kryesisht për faktin se ajo vlerësohej si avanpost i aksionit grek për ringjalljen e helenizmit në

<sup>54</sup> *Po aty*, F. MPB, V. 1935, D. 305, fl. 3, Nënprefektura e Bregut të Detit – MPB (pa datë).

<sup>55</sup> *AMPJ*, V. 1936, D. 268, fl. 53, MPB – MPJ, 2 nëntor 1935.

<sup>56</sup> *AQSh*, F. MPB, V. 1935, D. 1122, fl. 1-2, Relacion i MPB për shkollat në Himarë (pa datë).

<sup>57</sup> *Po aty*, F. MPB, V. 1936, D. 713, fl. 7-8, Telegram i kryepleqve të Dhërmiut, Himarës e Palasës (Simo Zoto, Llambro Neço, Dhimitri Dhimitriadhi dhe Perikli Milo) dërguar Mbretit Zog, 10 shtator 1936.

Shqipërinë e Jugut. Interesant është një promemorie e Kryeministrisë e datës 18 shtator 1936 mbi shkollat e Himarës<sup>58</sup>, në të cilën analizohej gjendja e krijuar në këto fshatra dhe shkaqet e saj. Gjithashtu bëhej edhe një historik i shkurtër i problemit të Himarës. Sipas këtij dokumenti, fakti që tre katunde përdornin gjuhën greke, përgjithësisht në këto brezat e fundit, ishte rrjedhojë e marrëdhënieve të ngushta, sidomos tregtare, që kishte patur Himara me ishujt grekë dhe së dyti, si rrjedhojë e propagandës së vazhdueshme të kishës greke. Kjo kishë, sidomos që nga koha e Katerinës II të Rusisë (shek. XVIII), kishte qenë vegla e parë e nacionalistëve grekë për greqizimin e popujve ballkanikë e sidomos të shqiptarëve të Jugut.

Por Himara, në tërësinë e saj, kishte qenë dhe ishte një krahinë shqiptare, ku sundonin edhe në këtë kohë cilësitë e racës shqiptare, madje më lart se në disa krahina të tjera të Shqipërisë. Për origjinën e saj shqiptare flisnin zakonet tërësisht shqiptare, labe, të banorëve të saj, emrat e familjeve dhe të vendeve, këngët, vajet e tyre, zakonet në lindje, martesat e vdekjeve si dhe festat e ndryshme.

Gjuhën greke banorët e kishin mësuar më vonë dhe ajo ishte më e re se sa zakonet e tyre të vjetra shqiptare të cilat, në vetvete, janë shprehje më konservatore e jetës shpirtërore të një populli se sa gjuha. Megjithatë, gratë e moçme ende flisnin shqip në të tre katundet në fjalë.

Banorët e këtyre tre fshatrave ishin edhe vetë të ndërgjegjshëm për identitetin e tyre shqiptar dhe e kishin deklaruar në çdo rast këtë të vërtetë. Ata e dinin se ishin një fis me lebërit e Vlorës e të Kurveleshit, me të cilët ende bënin krushqi, pavarësisht nga besimet fetare të ndryshme. Banorët e Palasës pohonin se e kishin prejardhjen nga Dukati i Vlorës, banorët e lagjes Gjipe të Dhërmiut krenoheshin me prejardhjen e tyre nga Kruja dhe me faktin se të parët e tyre kishin qenë ushtarë të Skënderbeut. Të tre fshatrat pohonin se e kishin farefisnin e tyre në Labëri, në Progonat, në Nivicë të Kurveleshit dhe në fshatrat Velçë, Tragjas etj.

Pra, këto fshatra ishin shqiptare dhe nuk mund të kishin statusin e minoritetit si çamët në Greqi. Për këtë arsye, për ta nuk mund të aplikoheshin rregullorja për shkollat e minoritetit grekofon. Ky mendim përputhej edhe me dëshirën e flaktë të një pjese të konsiderueshme të popullsisë së

<sup>58</sup> *AQSh*, F. Kryeministria, V. 1936, D. IV-418, fl. 15-22, Promemorje mbi shkollat e Himarës, 18 shtator 1936.

Himarës, Palasës e sidomos të Dhërmiut, e cila donte vetëm shkollën shqipe.

Në promemorie theksohej se “partia” që kërkonte shkollën shqipe përbëhej kryesisht prej të rinjve e intelektualëve, kurse “partia” grekofile përbëhej më tepër prej gjeneratës së vjetër, prej pleqve dhe priftërinjve.

Në shtator 1936, edhe Ministria e Brendshme nënvizonte përkatësinë shqiptare të popullsisë së Himarës si një arsye themelore për të mos aplikuar rregulloren e shkollave minoritare të vitit 1935 në tre fshatrat e kësaj krahine<sup>59</sup>. Por ajo kërkonte që të shkohej edhe më tej. Sjelljen e butë të qeverisë, ajo e cilësonte si një shkak që kishte inkurajuar grekomanët. Duke patur parasysh edhe paratë e shumta që kishte derdhur dhe po derdhte Greqia në Himarë dhe përgjithësisht në jug të vendit, ky qëndrim pasiv i qeverisë konsiderohej i papërshtatshëm. Prandaj ajo propozonte: 1 - Të detyrohej popullsia të paguante rregullisht taksat; 2 - Konsujt grekë të Sarandës e të Vlorës, jo vetëm të mbikëqyreshin kur shkonin në Himarë por, mundësisht, edhe të izolohehin. Gjithashtu të ndalohej ardhja e propagandistëve të huaj grekë; 3 - Ndaj disa personave që ishin agjentë të konsullatave greke si Thanas Bebi në Vlorë, Dhimitër Muço e Vangjel Rusi në Dhërmi, Spiro Milo në Himarë, Sokrat Papaj e Miho Zhango në Sarandë etj., të ushtroheshin kontrole të forta dhe të mos u lihej fushë e lirë për të vepruar. Gjithashtu të mbikëqyreshin shoferët që transportonin postën e gazetat prej Himare në Vlorë e Sarandë. Ata persona që ishin drejtuesit e zbatuesit kryesorë të kësaj propagande, mundësisht, të dëboheshin jashtë Shqipërisë; 4 - Nxënësit e moshës shkollore të detyroheshin të shkonin në shkollë dhe ndaj atyre që nuk shkonin të zbatoheshin masat përkatëse ligjore; 5 - Nxënësit që shkonin në shkollat shtetërore dhe mbështetësit e shkollës shqipe duhej të gëzonin lirinë e vet të plotë; 6 - Nënprefekti, rreth-komandanti dhe gjykatësit duhej të ishin nëpunës nga më të zgjedhurit, me kulturë dhe me eksperiencë në jetën administrative, me sjellje të mirë, me takt dhe energjikë.

Ministria e Brendshme paralajmëronte se, nëse nuk do të merreshin masa të shpejta dhe të forta, do të kishte dy rrjedhoja negative: *e para*, të tre katundet do të bëheshin minoritet grek, në kuptimin e vërtetë të fjalës;

---

<sup>59</sup> *Po aty.*

*e dyta*, greqishtja do të përhapej edhe në katundet e tjera të Himarës, në Vuno, Qeparo, Pilur e Kudhës<sup>60</sup>.

Fitorja e arritur në Gjykatën e Hagës i inkurajoi konsullatat greke të intensifikonin aktivitetin e tyre. Në fillim të vitit shkollor 1936-37, konsullata greke e Vlorës dërgoi në Palasë të Himarës 600 napolona, me qëllim që banorët e atjeshëm të nxiteshin për të kërkuar shkolla private greke dhe të mos u bindeshin këshillave të qeverisë shqiptare. Gjithashtu ajo u premtoi banorëve të Palasës se ishte gati të pranonte 60 djem për studime në Greqi, me bursa të shtetit grek<sup>61</sup>.

Prefektura e Vlorës konstatonte se në dy vitet e mëparshme numri i nxënësve që kishin vazhduar shkollën shqipe kishte qenë më i madh se sa numri i nxënësve të vitit 1936-37. Si shkak të këtij pakësimi ajo cilësonte propagandën e konsullatave greke dhe të hollat që ato i kishin shpërndarë popullsisë, me qëllim që t'i mbushnin mendjen të bënte qëndresë për mosdërgimin e fëmijëve në shkollë, sepse kështu do të fitonin të drejtën e minoritetit<sup>62</sup>. Ajo sugjeronte që në Himarë të lejohej mësimi i gjuhës greke në masën e mëparshme dhe mësimi i fesë, pastaj të aplikoheshin sanksionet e ligjit të arsimit dhe të mos përfillehin ankimet eventuale. Duke pasur parasysh se, nga pikëpamja e së drejtës ndërkombëtare, Himara nuk gëzonte asnjë privilegj minoritar, as për gjuhën dhe as për kurrjë tjetër dhe, duke konstatuar se mosbindja e disa himarjotëve ishte e frymëzuar nga propaganda greke, prefektura e Vlorës propozonte marrjen e këtyre masave:

1 - Sanksionet që parashikonte ligji të zbatoheshin rigorozisht, pasi një masë ligjore nuk linte shteg për ankesa;

2 - Të tolerohej mësimi i fesë, i cili nuk ishte i dëmshëm;

3 - Në qoftë se situata politike e lejonte, duheshin marrë masa të forta dhe të internoheshin organizatorët e lëvizjes për shkollat greke, Thanas Bebi e Ilia Billo, të cilët po drejtonin propagandën greke dhe ishin shpërndarësit kryesorë të të hollave që vinin nga Greqia;

4 - Shkollat private në gjuhën greke nuk duheshin lejuar në asnjë mënyrë, pasi ato, jo vetëm që ishin jashtë ligjit, por do të ishin inkurajimi më i madh për propagandistët grekë dhe do t'u krijonin atyre bindjen se

<sup>60</sup> *Po aty*.

<sup>61</sup> *AMPJ*, V. 1936, D. 268, fl. 19, MPB – MPJ, 23 shtator 1936.

<sup>62</sup> *AQSh*, F. MA, V. 1937, D. 129, fl. 2, Prefektura Vlorë – MPB, 1 dhjetor 1936.

shteti shqiptar ishte angazhuar për njohjen e të drejtave të Himarës si minoritet.

Një masë tjetër e mundshme konsiderohej angazhimi në zbatimin e politikës shtetërore i të gjithë himarjotëve që ishin nëpunës të shtetit, të cilët përbënin një numër të konsiderueshëm. Mobilizimi i tyre duhej të bëhej duke i kërcënuar me pushimin nga puna. Në këtë mënyrë, ata do të detyroheshin të nxisnin njerëzit e tyre t'u bindeshin plotësisht urdhrave të qeverisë dhe ligjeve të shtetit e të dërgonin fëmijët në shkolla. Ky propozim, me sa duket, synonte që shteti shqiptar t'i kundërvihej me të njëjtën monedhë politikës së korrupsionit ekonomik dhe shtrëngimit administrativ që po bënte qeveria greke ndaj popullsisë së Himarës.

Pra, himarjotëve që kundërshtonin shkollën shqipe, nuk duhej t'u njihej asnjë e drejtë jashtë ligjit dhe të pengohej me rigorozitet dalja e fëmijëve të tyre jashtë shtetit për studime, pasi kështu, me kalimin e kohës, prindërve do t'u vinte keq t'i linin fëmijët pa shkollë për një kohë të gjatë dhe do të detyroheshin t'i dërgonin në shkollat shtetërore<sup>63</sup>.

Edhe në vitin 1937, Ministria e Brendshme vijoi të këmbëngulte në ndalimin e hapjes së shkollave greke në Himarë, duke argumentuar se popullsia e këtyre tre fshatrave ishte një minoritet gjuhësor dhe jo etnik<sup>64</sup>. Situata mbetej thuajse e njëjtë si më parë. Siç njoftonte prefektura e Vlorës, popullsia e këtyre fshatrave ishte ndarë në dy grupe, në atë minoritar dhe në grupin proqeveritar. Kështu përçarja vijonte të ishte e evidente<sup>65</sup>. Por tashmë pjesa e popullsisë që kishte kërkuar shkolla greke ishte më pak entuziaste, pasi edhe këta po e shihnin vetë demoralizimin e djemve të tyre që i kishin hequr nga shkolla dhe i kishin lënë rrugëve. Ata gjithashtu po shihnin se qeveria greke nuk po interesohej për ta, ashtu siç e kishin menduar. Autoritetet lokale mendonin se edhe këta mund të pranonin të tërhiqeshin nga rruga e mëparshme<sup>66</sup>. Nënprefektura e Himarës sugjeronte që, ndaj tyre, autoritetet shqiptare të vijonin të mbanin qëndrim mospërfillës, pasi ata që përkrahnin me vendosmëri idenë greke ishin të pakët, aq sa pothuajse mund të numëroheshin me

<sup>63</sup> *Po aty*.

<sup>64</sup> *AQSh*, F. MA, V. 1937, D. 129, fl. 3-4, Raport i MPB mbi shkollat në Himarë (pa datë).

<sup>65</sup> *Po aty*, F. MPB, V. 1937, D. 204, fl. 2, Prefektura Vlorë - MPB, 17 maj 1937.

<sup>66</sup> *Po aty*, F. MA, V. 1937, D. 129, fl. 272, Nënprefektura e Bregut të Detit – Prefekturës Vlorë, 6 gusht 1937.

gishtat e dorës, ndërsa pjesa e varfër dhe e paditur e popullsisë u kishte shkuar atyre pas, pa asnjë ndjenjë, por vetëm për qëllime materialiste<sup>67</sup>.

Pikërisht në këtë kohë, në gusht të vitit 1938, në zbatim të marrëveshjes së arritur me qeverinë greke, Këshilli i Ministrave i Shqipërisë vendosi parimisht që të lejohej hapja e tre shkollave minoritare greke në Himarë. Për rëndësinë që ka është me vend që ta japim të plotë këtë vendim:

“Në bazë të marrëveshjes me përfaqësuesin e Greqisë në Tiranë, ku qeveria helenike pranon ta shtojë nga pesë, sa janë sot, në dhjetë, numrin e shkollave shtetërore në Çamëri, ku të mësohet gjuha shqipe 10 orë në javë, për çdo shkollë, dhe, veç kësaj, pranon që mësuesit të propozohen nga komunitetet minoritare shqiptare, të pëlqehen prej përfaqësive tona dhe pastaj të emërohen në detyrë prej qeverisë greke, porse ajo qeveri kërkon, në shkëmbim, që të çelen në Himarë, Palasë e Dhërmi tre shkolla, të cilat të mbahen me shpenzimet e komuniteteve grekofone përkatëse.

Këshilli i Ministrave vendosi:

Pranimin e këtij akordi, pasi nuk vjen në kundërshtim me dispozitat e rregullores mbi funksionimin e shkollave private të minoriteteve të datës 2/11/1935, dhe, nga ana tjetër, mbështetet mbi parimin e reciprocitetit, autorizon Ministrinë e Arsimit për të aprovuar parimisht kërkesat që do t’i drejtohen nga të interesuarit për çeljen e tri shkollave minoritare në Himarë, por çelja definitive të lejohet kur Ministria e Jashtme të lajmërojë për fillimin efektivisht të mësimit të gjuhës shqipe në shkollat e 10 katundeve të Çamërisë; thekson nevojën që të sigurohet mësimi, së paku i gjuhës shqipe në shkollat minoritare të Himarës; autorizon Ministrinë e Punëve të Jashtme t’ia komunikojë qeverisë greke këtë vendim, që mbështetet, pikësepari, në dëshirën e qeverisë shqiptare për t’i shtuar sa më tepër marrëdhëniet miqësore me shtetin fqinj<sup>68</sup>.

Vendimi i qeverisë shqiptare ishte një kthesë e rëndësishme dhe një hap prapa në politikën e saj për konsolidimin e arsimit dhe, më gjerë, të identitetit kombëtar në Himarë. Marrëveshja e arritur me qeverinë greke kishte një karakter tërësisht asimetrik. Së pari, Himara nuk përfaqësonte një minoritet etnik e aq më tepër kombëtar siç ishte Çamëria, prandaj nuk

<sup>67</sup> *Po aty*.

<sup>68</sup> *AQSh*, F. MA, V. 1937, D. 129, fl. 274, Vendim i Këshillit të Ministrave, nr. 965, dt. 25.08.1937.

mund të trajtohej me të njëjtën mënyrë; së dyti qeveria greke nuk kishte premtuar të hapte shkolla minoritare private shqipe në Çamëri, siç ishte angazhuar pala shqiptare në zonën e minoritetit grek dhe së fundi edhe në Himarë, por vetëm të lejonte mësimin e gjuhës shqipe në shkollat shtetërore greke të Çamërisë. Ky ishte një dallim shumë i madh. Shtimi i shkollave ku mësohej gjuha shqipe në Çamëri ishte në favor të interesave shqiptare, por reciprociteti duhej të ishte vendosur në raport me shkollat greke që ishin lejuar të funksiononin në zonat e minoritetit grekofon. Hapja e shkollave greke në zonën e Himarës, jo vetëm që godiste rëndë të gjitha përpjekjet dhe procesin e afirmimit kombëtar të popullsisë shqiptare të Himarës por, për më tepër, krijonte precedentin dhe modelin e rrezikshëm të ringjalljes së helenizmit në gjithë Shqipërinë e Jugut, duke krijuar imazhin e rikthimit të *status quo*-së së periudhës osmane, ku kisha dhe shkolla greke kishin qenë dominuese.

Shtimi i pesë shkollave në Çamëri, në të cilat do të jepeshin 10 orë mësim të gjuhës shqipe në javë, nuk sillte ndonjë ndryshim cilësor në njohjen dhe afirmimin e të drejtave të minoritetit kombëtar shqiptar në Greqi, i cili ishte njohur si i tillë nga shteti grek dhe nga aktet e tjera ndërkombëtare. Ky kompromis jo parimor e deformonte edhe karakterin e përpjekjeve që duhej të bënte shteti shqiptar për të kërkuar zbatimin e të njëjtave standarde nga shteti grek, si ato që i ishin imponuar Shqipërisë për minoritetet.

Duke bërë këtë “kompromis”, Greqia fitoi shumë në disa drejtime. Së pari, ajo e ndaloi dhe arriti të shmangë mundësinë që iu krijua qeverisë shqiptare, veçanërisht pas vendimit të Gjykatës së Hagës, që të shtronte në rrugë ligjore në organizmat ndërkombëtare njohjen dhe respektimin e të drejtave të minoritetit shqiptar në Çamëri. Së dyti, ajo e kanalizoi çështjen e të drejtave të minoritetit shqiptar thjesht në një marrëveshje qeveritare të vullnetit të mirë, së cilës mund t’i bishtnonte në çdo rast që do ta gjykonte të përshtatshëm. Së treti, ajo e vuri realizimin e të drejtave të shqiptarëve të Çamërisë në një bazë pariteti me realizimin e kërkesave të saj për shtrirjen e helenizmit në Shqipërinë e Jugut, pra, si koncesion, ajo kërkonte greqizimin e popullsisë shqiptare. Në këtë mënyrë, ajo synonte të siluronte fuqishëm e me pasoja shkatërrimtare procesin e formimit e të konsolidimit të institucioneve kombëtare shqiptare dhe procesin e unifikimit kombëtar që ishte jetik për Shqipërinë.

Koha provoi se ato pak lëshime që bëri qeveria greke në Çamëri ishin të pjesshme, të përkohshme dhe aspak të qëndrueshme. Ajo do t'i sfumonte ato pak nga pak, me anë të një politike konsistente kufizuese, e cila ishte shumë efektive dhe e kalkuluar mirë për t'u shërbyer objektivave të asimilimit dhe të spastrimit etnik që shteti grek po zhvillonte prej disa dekadash në Çamëri.

Hapja e shkollave private minoritare në Himarë paragjykonte drejtësinë dhe karakterin parimor të politikës që kishte ndjekur shteti shqiptar qysh nga viti 1920 e në vijim. Ky lëshim përbënte një precedent të rrezikshëm për të ardhmen. Ai i jepte modelin qeverisë greke se, duke kombinuar presionet ndaj shtetit shqiptar, me disa lëshime minimale e lehtësisht të mundshme për t'u abroguar në të ardhmen, të hapte një shteg shumë të dobishëm për të, që të pengonte gjithë procesin historik të konsolidimit të ndërgjegjes dhe institucioneve kombëtare shqiptare në të gjitha grupet e popullsisë shqiptare. Mbi të gjitha, hapej një rrugë që të inkurajonte elementët grekomanë të vijonin rezistencën e tyre sepse, sipas shembullit të Himarës, ata mund t'ia arrinin qëllimit që t'ia impononin shtetit shqiptar këto lëshime edhe në krahina të tjera shqiptare, duke i shndërruar ato gradualisht në zona të minoritetit kombëtar grek. Në këtë mënyrë, ishte çelur një shteg shumë i rrezikshëm për të ardhmen e shtetit-komb në Shqipëri.

Hapja e shkollave private minoritare u shoqërua me protesta të një pjese të popullsisë vendase me ndjenja shqiptare, e cila mbeti e habitur dhe thellësisht e zhgënjyer nga ky ndryshim drastik i politikës së qeverisë kundrejt Himarës. Një protestë të tillë bëri fshati Dhërmi më 13 shtator 1937, të cilën e nënshkruan 47 persona dhe fshati Palasë të cilën e nënshkruan 20 persona. Ata të gjithë kërkonin funksionimin vetëm të shkollave shtetërore shqipe<sup>69</sup>. Disa ditë më vonë, kryepleqtë e katundeve Himarë, Dhërmi e Palasë dhe një përfaqësi e prindërve që i kishin fëmijët në shkollat shtetërore, me në krye Nikolla Janin, iu drejtuan nënprefekturës së Himarës, së cilës i shprehën protestën e tyre për hapjen e shkollave greke në fshatrat e tyre. Ata këmbëngulën se arsimi shqip kishte ecur drejt konsolidimit dhe fuqizimit. Kështu, qysh në ditën e parë të shkollës në fshatin Dhërmi ishin regjistruar në shkollën shtetërore 45 fëmijë, në fshatin Palasë 24 fëmijë dhe shpresohej se në këtë vit do të

<sup>69</sup> *Po aty*, F. MA, V. 1937, D. 129, fl. 278-279, Letër e katundit Dhërmi e Palasë dërguar nënprefekturës Himarë, 13 shtator 1937.

regjistroheshin në shkollat shqipe gjithë fëmijët e këtyre fshatrave. Por, ata ishin tërhequr disi, “pasi kishin dëgjuar lajmin e zi të çeljes së shkollave minoritare”<sup>70</sup>. Kryepleqtë e këtyre fshatrave deklaruan se propaganda greke kishte përhapur lajme se, pas hapjes së shkollave greke në Himarë, Dhërmi e Palasë, do të hapeshin shkolla minoritare edhe në qytetin e Vlorës. Më pas, do të çelej edhe një gjimnaz grek në Delvinë.

Ndërkohë, qeveria greke po përpiquej t’i tërhiqte ortodoksët shqiptarë pas vetes, duke akorduar bursa për djemtë e tyre në Greqi dhe duke emëruar disa nga djemtë e fshatrave shqiptarë si mësues në shkollat minoritare. Pasi denonconin këto veprime greke, kryepleqtë e fshatrave të Himarës i bënë këtë deklaratë nënprefektit: “Neve dimë vetëm që jemi shqiptarë, siç kemi deklaruar dhe provuar në sa e sa raste por, si në çdo kënd të Shqipërisë, ndër të moshuarit, ende nuk është rrënjësor ndjenja kombëtare dhe ata jetojnë me mentalitete të përfituara prej të huajve. Mbasi vendi ynë, fatkeqësisht, ka qenë i okupuar prej të huajve për një kohë të gjatë, e ndryshoi natyrën e bukur e thjeshtësinë që na kishte karakterizuar dhe tash kemi edhe elemente të ndryshkur që sjellin ngatërresat e tashme, pa u menduar se po u bëjnë varrin fëmijëve të tyre. Edhe në këtë rreth pra jemi duke vuajtur, ca më tepër, nga persona të atillë, me pretekste të dobëta dhe epidemike. Një sëmundje e tillë po rrezikon jetën tonë e po trondit edhe interesat vitale të shtetit e të kombit. Ne nuk jemi dhe as mund të jemi grekë. Përveç të tjerave, ne dimë edhe origjinën nga kemi ardhur. Si shembull mund të sjellim familjet Spiro Milo të ardhur nga Progonati i Labërisë, fisi Zoto i ardhur nga Vithkuqi i Korçës; krejt familjet e lagjes Gjoleka, që kanë ardhur nga Kruja, po kështu pothuaj gjithë të tjerët... Prandaj neve lusim që shteti të na njohë të drejtat thjesht shqiptare, ashtu si dhe gjithë shqiptarëve të tjerë, e të na mbrojë nga propagandat e huaja, duke na çelur edhe neve shkollën shqipe dhe ajo të mos transformohet në greqishte, pasi këtë të fundit neve e përbuzim kategorikisht, mbasi jemi shqiptarë dhe asgjë tjetër. Nuk besojmë se e ndershmja qeveri të na bëjë viktimë të intrigës së huaj dhe të personave të pakët të shitur tek të huajt, por përkundrazi, kërkojmë që të na sigurohet edukata e thjeshtë kombëtare. Ky gjest i jonë është krejt brenda caqeve reale, e kundërta është sikur qeveria vetë do kërkojë paralizimin tonë, duke na bastarduar të vetmin ideal shqiptar që kemi dhe

<sup>70</sup> *Po aty*, F. MA, V. 1937, D. 129, fl. 277, Nënprefektura e Bregut të Detit – Prefekturës Vlorë, 20 shtator 1937.

që ëndërrojmë. Lutemi pra që e ndershmja qeveri të na sigurojë të drejtat tona për vazhdimin e ekzistencës së shkollës shqiptare në katundet tona...<sup>71</sup>

Kjo deklaratë e pjesës atdhetare të popullsisë së Himarës tingëllonte si një thirrje SOS për qeverinë, ajo ishte një akuzë e tërthortë por shumë e fortë dhe prekëse kundër kthesës së gabuar që kishte marrë politika e saj në drejtim të Himarës.

Me gjithë politikën liberale të qeverisë shqiptare, tendencat për përhapjen e helenizmit nuk u zbutën por vijuan të ishin konsistente. Pas hapjes së shkollave private greke në Himarë, Dhërmi e Palasë, me vendimin e Këshillit të Ministrave të datës 25 gusht 1937,<sup>72</sup> grupi grekofil nuk u kënaq plotësisht. Në prill 1938 ai u hodh në sulm për likuidimin e plotë të shkollës shqipe. Ata nxisnin fëmijët e tyre të ngacmonin nxënësit që shkonin në shkollat shqipe dhe po bënë presion që popullsia të mos u paguante rroga kryepleqve të Palasës, Perikli Milo dhe të Himarës, Simo Zoto, që ishin të zgjedhur nga vetë popullsia e këtyre fshatrave. Kjo ndodhte ngaqë këta kryepleq kishin luftuar kundër përpjekjeve për t'i shpallur këto fshatra si minoritare dhe kishin përkrahur propagandën shqiptare. Grupi grekoman po përpiqej që vitin e ardhshëm shkollor të bllokonte tërësisht funksionimin e shkollës shtetërore shqipe<sup>73</sup>. Ndërkohë, prefekturës së Vlorës i erdhën informacione se në shkollat private minoritare të Himarës po përdorehin për mësim dhe ishin varur në mure harta gjeografike, në të cilat një pjesë e Shqipërisë së Jugut paraqitej si territor i Greqisë<sup>74</sup>.

Në qershor 1938, nënprefektura e Himarës e cilësonte situatën të qetë dhe njoftonte se edhe ata banorë që vetëquheshin minoritarë shfaqnin kënaqësi për administratën, qeverinë e shtetin shqiptar dhe adhurimin për Mbretin Zog. Por gjithashtu, ajo njoftonte se vijonin përpjekjet për rigjallërimin e venomeve në lidhje me disa taksa shtetërore. Në krye të këtyre përpjekjeve qëndronte fshati Himarë, ku propaganda greke ishte e

<sup>71</sup> *Po aty.*

<sup>72</sup> *Po aty*, F. MPB, V. 1938, D. 217, fl.16, Komanda e Xhandarmërisë Himarë – Komandës së Përgjithshme të Xhandarmërisë, 21 prill 1938.

<sup>73</sup> *Po aty.*

<sup>74</sup> *AQSh*, F. MPB, V. 1938, D. 217, fl. 17, Prefektura Vlorë – Nënprefekturës Himarë, 17 maj 1938.

fuqishme<sup>75</sup>. Në katër katundet e tjera, Vuno, Qeparo, Pilur e Kudhës gjendja ishte e mirë, por edhe këtu nuk ishte rrënjësor siç duhej “ideja e plotë e kombësisë”. Pengesë cilësoshin disa pleq me mentalitete të errëta. Por shfaqej shpresa se rinia po rritej me një shpirt e frymë atdhetarie. Banorët që kërkonin gjuhën greke në shkollë, pohonin se e bënë këtë gjë me synimin për të marrë ndonjë bursë greke. Tashmë tek një pjesë e tyre po shfaqeshin disa shenja pendese, ndërsa tek disa drejtues të propagandës minoritare nuk vërehej më entuziazmi i mëparshëm, kur ishte dhënë leja për çeljen e shkollave minoritare. Atëherë, ata kishin marrë para me shumicë nga Greqia, por tani, me sa dukej, me përjashtim të Niko Milos dhe 2-3 bashkëpunëtorëve të tij, nuk merrnin gjë. Ndërsa mësuesit “minoritarë” vijonin të paguheshin nga konsullatat greke.

Në shkollat shtetërore të Himarës, në qershor 1938, shkonin pak fëmijë, prindërit e të cilëve kërkonin që atyre t’u akordohej bursë për në shkollat e mesme<sup>76</sup>.

Nënprefektura e Himarës ishte në dilemë se çfarë politike duhej ndjekur. Ajo lëkundej midis një politike nacionaliste dhe një vije liberale. Alternativa e parë sugjeronte marrjen e disa masave për të kundërbalancuar propagandën dhe fushatën greke për helenizimin e Himarës. *Së pari*, nga grupi “minoritar” i Himarës të mos pranohej askush në nëpunësira shtetërore, as në shoqëri private e anonime dhe as në banka apo institute të tjerë. Nëpunësit që ndodheshin në këto institucione dhe që nuk i kishin përkrahur përpjekjet e shtetit për të frenuar propagandën greke në Himarë ose ata që bënë një lojë të dyfishtë në këtë drejtim, të largoheshin nga nëpunësia. *Së dyti*, fëmijëve të këtij grupi të mos u jepej asnjë bursë shtetërore dhe atyre, që i kishin marrë këto bursa, t’u priteshin. Këtij grupi t’i mohoheshin lehtësirat e çdo lloji<sup>77</sup>.

Si një alternativë tjetër liberale, nënprefektura propozonte që gjendja të lihej të ecte në rrjedhën e vet. Himarjotët të këshilloheshin vazhdimisht që të hiqnin dorë nga rruga e gabuar dhe të përqafonin idenë kombëtare shqiptare, pasi ata ishin thjesht shqiptarë. Ata të shiheshin gjithnjë me sy

<sup>75</sup> *Po aty*, F. MPB, V. 1938, D. 216, fl. 2-4, Nënprefektura e Bregdetit - Prefekturës Vlorë, 22 qershor 1938.

<sup>76</sup> *Po aty*.

<sup>77</sup> *Po aty*.

të mirë, të mos përbuzeshin dhe të mos u krijohej ndjesia se këta, si minoritarë, nuk kishin dhe nuk mund të gëzonin në shtetin shqiptar barazi dhe lehtësira në çdo veprim, njëlloj me të tjerët. Ata duhej të priteshin në zyrat shtetërore “me një lloj buzëqeshje dhe në një mënyrë të tillë” që t’u lihej të kuptonin se edhe ata “gëzonin njësinë, drejtësinë dhe paanësinë e plotë”, si çdo shqiptar e shtetas i mirë shqiptar, me qëllim që, mundësisht, të kuptonin e të pendoheshin për gabimin që kishin bërë.

Gjithashtu, nënprefektura kërkonte në mënyrë kategorike që nëpunësit e shtetit në Himarë nuk duhej të tregonin asnjë shenjë inferioriteti e përlulje, por të ishin seriozë e korrektë në qëndrimet kundrejt grupit “minoritar”. Për shembull, ata nuk duhej t’u bënin tolerime atyre që dërgonin fshehur për të studiuar fëmijët e tyre në Greqi, por të merrnin masat e nevojshme ligjore kundër tyre. Gjithashtu, ajo sugjeronte që nxënësve të këtyre shkollave “minoritare” në Himarë nuk u duhej dhënë, në asnjë mënyrë, bursë shteti. Fëmijët e grupit “minoritar”, që kishin mbaruar shkolla të mesme e të larta jashtë shtetit, nuk duhej të pranoheshin në nëpunësi a në institute të tjera, pa hequr dorë nga ideja e gabuar “minoritare”. Gjithashtu bursat do të jepeshin atëherë kur ata t’i dërgonin të gjithë fëmijët, vëllezërit e motrat e tyre në shkolla shtetërore<sup>78</sup>.

Ministria e Punëve të Brendshme i hodhi poshtë në mënyrë kategorike këto propozime me një ngjyrim nacionalist, dhe vuri në dukje se edhe pjesa që përkrahte shkollat greke kishte të drejtë të ishin nëpunës të shtetit dhe të gëzonin të drejta ligjore të njëjta me shtetasit e tjerë<sup>79</sup>.

Elementët grekomanë në Himarë u bënë edhe më agresivë në luftën kundër shkollës shqipe. Në gusht të vitit 1938, grupi “minoritar” i fshatrave Himarë, Dhërmi e Palasë po bënte përpjekje për të marrë në zotërim godinat e shkollave shtetërore në këto katunde. Ky lajm u përhap me shpejtësi dhe dekurajoi e shtoi shqetësimin e pjesës kombëtare shqiptare në këto fshatra dhe në fshatrat e tjerë përreth. Veçanërisht, pjesa që mbështeste shkollat shtetërore në komunën e Vunoit, së bashku me pleqësitë e katundeve, po përgatiteshin t’i drejtonin një lutje qeverisë që ajo të mos lejonte dhënien e godinave të shkollave shtetërore këtyre

<sup>78</sup> *Po aty*.

<sup>79</sup> *Po aty*, F. MPB, V. 1938, D. 216, fl. 5, MPB – Prefekturës Vlorë, 1 korrik 1938.

personave<sup>80</sup>. Edhe prefektura e Vlorës e konsideronte të rrezikshme për interesat kombëtare shqiptare dhënien e ndërtesave të shkollave shtetërore grupit “minoritar”.<sup>81</sup>

Në këtë situatë disi të amullt po e gjente pushtimi fashist procesin e konsolidimit të institucioneve kombëtare në Himarë. Nacionalizmi grek dhe rryma grekomane kishin tendenca të gjallëroheshin, duke e ndërë se shteti shqiptar ishte në rrezik dhe kjo hapte një fushë veprimi më të favorshme për ta. Qeveria dhe nacionalizmi grek do ta konceptonin shembjen e shtetit shqiptar pas pushtimit italian si një shans të rrallë të ofruar për të realizuar objektivat e vjetër ekspansionistë kundrejt Shqipërisë së Jugut.

### *S u m m a r y*

#### THE EFFECT OF THE HAGUE COURT VERDICT CONCERNING PRIVATE SCHOOLS IN THE PROCESS OF NATIONALIZATION OF ALBANIAN INSTITUTIONS (1935-1938)

The verdict of the League of Nations which forbade the nationalization of private schools in the area of Greek minority urged the Greek chauvinist feelings and aspirations even in other regions where these tendencies seemed to have lessened up so far. The consulates and the Greek agents made it to enliven the Greek chauvinist movement in the prefecture of Korça, on the question of Orthodox Church, on education and further more on other matters of Greek chauvinist feelings. The Greek circles were so heartened by the new situation caused after the verdict of The Hague Court, that they were exerting pressure even on Korça nationalist orthodox Christians to make them give up supporting the Autocephalous Church and other national institutions. The policy of the Albanian government to protect the national institutions received a hard attack even from Italy which insisted and exerted high pressure on the reopening of Italian schools, especially the Catholic ones. The Albanian public and press reacted in favor of the national institutions. In 1938 the phenomenon of opening minority schools in non-minority villages went on. These actions were taken

<sup>80</sup> *Po aty*, F. MPB, V. 1938, D. 217, fl. 31, Nënprefektura e Bregdetit-Prefekturës Vlorë, 13 gusht 1938.

<sup>81</sup> *Po aty*, F. MPB, V. 1938, D. 217, fl. 31, Shënime të prefekturës Vlorë.

under the urge of Greek consulates. The acceptance of The Hague Verdict from the Albanian government made the Greek chauvinist elements even more active in Himara. On the other hand Himara activists with pro-Albanian feelings required that the national institutions be strongly protected. Himara was a concern for the government, chiefly because of being considered as a detachment of the Greek action for the enlivenment of Hellenism in South Albania.

In August 1938, in accordance with the application of the agreement achieved with the Greek government the Council of Ministers of Albania decided principally to allow the opening of three Greek minority schools in Himara. The decision of the Albanian government was an important change and a step backwards in its policy on the consolidation of education and further of the national identity in Himara. The achieved agreement with the Greek government had a totally asymmetric character. By June 1938 the state schools of Himara were attended only by a few children whose parents required that their children be awarded scholarships for the high school.